



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 50, Datë 20.02.2023

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUN ENERGY SOLUTIONS” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, NË SHEQ MARINAS, TOPOJË, BASHKIA FIER

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1, gërma “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 20.02.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 571/1 prot., datë 18.02.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Sheq Marinas, Topojë, Bashkia Fier”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Sun Energy Solutions” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 571 prot., datë 06.02.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendodhje në fshatin Sheq Marinar, Njësia Administrative Topojë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë

elektrike duhet të depozitohet në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer pagesën, sipas përcaktimeve të Aneksit A “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se shoqëria “Sun Energy Solutions” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të rregullores për nenin 9, pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmën “c”; për pikën 2, gërmat “a”, “b”, “d” “e” dhe “f”.
- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se nevojitet të plotësohet dokumentacioni si vijon:
Neni 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”:** Aplikuesi duhet të depozitohet vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshmi penalteti) për administratorin dhe për vetë shoqërinë “Sun Energy Solutions” sh.p.k.
- **gërma “c”:** Aplikuesi duhet të depozitohet në ERE strukturën organizative të shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k., së bashku me stafin teknik të dedikuar për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”:** Aplikuesi duhet të bëjë me dije nëse ka shlyer gjobën ndaj institucionit të Sigurimeve Shoqërore dhe nëse po, të depozitohet në ERE vërtetimin përkatës për shlyerjen e të gjitha detyrimeve.
- **gërma “b”:** Aplikuesi duhet të depozitohet letërën e referencës së bankës, origjinale ose fotokopje të njësuar me origjinalin dhe të bëjë me dije hapat e ndjekur për nënshkrimin e kontratës apo marrëveshjes përkatëse me bankën dhe nëse kjo marrëveshje është nënshkruar, duhet ta depozitohet në ERE.

Aplikuesi duhet të depozitohet në ERE aktet përkatëse për të materializuar marrëveshjen e bashkëpunimit dhe/ose llogari bankare të shoqërisë, dokumente në të cilat duhet të vërtetohet se ajo zotëron aftësinë financiare për të garantuar 20% të vlerës së investimit, sipas parashikimeve të planit të biznesit të depozituar nga vetë ajo.

Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës

Pika 2.1

- **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE, në format original, ose fotokopje të njësuar me origjinalin, shkresën e OSSH sh.a. dhe marrëveshjen përkatëse për lidhjen me rrjetin. Po ashtu duhet të bëjë me dije nëse ka ndodhur ndryshimi i pikës së lidhjes që referohet në shkresën e OSSH sh.a.
- Gjithashtu, aplikuesi duhet të bëjë me dije nëse ka filluar punimet për ndërtimin e centralit.
- ERE, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se nga shqyrtimi i dokumentacionit teknik jetëgjatësia e pritshme e centralit rezulton të jetë 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Sun Energy Solutions” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaike me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Sheq Marinas, Topojë, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI